



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KPPP.nr.1340/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari Gent Bekeri, në çështjen përbarimore të kreditorit “Jack Daniel’s Properties” Inc., e regjistruar në USA, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit Avokate A.S. nga Prishtina, kundër debitorit N.T “BENI”, me NUI: 80015739, me seli në Prishtinë, në lagjen “Dardania” nr.26, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit Shoqëria e Avokatëve “Vokshi & Lata”, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit, të ushtruar kundër Urdhrit Përbarimor P.nr.592/21 të datës 24.08.2021 të Përbaruesit Privat Eset Murati, me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datën 18.08.2023 merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit N.T “BENI”, dhe SHFUQIZOHET Urdhri Përbarimor P.nr.592/21 i datës 24.08.2021 i Përbaruesit Privat Eset Murati.

A r s y e t i m

Përbaruesi Privat duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Jack Daniel’s Properties” Inc, me datë 24.08.2021, ka lëshuar Urdhrin Përbarimor P.nr.592/21, me të cilin ka lejuar përbarimin në bazë të dokumenteve përbaruese – Aktgjykimi II.Ek.nr.328/2017 i datës 25.07.2019, Aktvendimi mbi korrigjim Ek.nr.328/2017 i datës 27.08.2019, Aktgjykimi plotësues Ek.nr.328/2017 i datës 19.09.2019, me të cilën urdhërohet debitori që brenda 7 ditësh nga marrja e urdhrit, të ekzekutoj vendimet e lartcekura ose përndryshe kreditori autorizohet të angazhoj një kompani shkatërrimi për të shkatërruar mallrat në vend të debitorit si dhe debitori të urdhërohet t’i paguaj vlerën prej 14.000.00 € në emër të mbulimit të shpenzimeve me qëllim të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të sipër cekura, me kamatë vjetore 8% duke llogaritur nga data 24.08.2021 e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet përbarimore që do rrjedhin nga kjo procedurë nën kërcënimin e ekzekutimit të detyruar nga pasuria e debitorit.

Debitori, në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor ka deklaruar se ky propozim për përmbardim është i pa bazë për arsye se dispozitivi i propozimi për përmbardim është i paqartë dhe i pa ekzekutueshëm, sepse nuk është sqaruar fare cili është veprimi konkret për të cilin detyrohet debitori. Në vazhdim deklaron në procedurë përmbardimore nuk mund të ketë dispozitiv që përcakton detyrime alternative si dhe thekson se aktgjykimi në pjesën që ka të bëjë me shpenzimet e magazinimit nuk është i përshtatshëm për përmbardim sepse askund nuk përmendet shuma 14,000.00 € si dhe magazinimi i mallit është bërë në depon e Doganës së Kosovës kështu që debitori nuk ka shkaktuar asnjë shpenzime. Duke u bazuar në të lartcekurat i propozon Gjykatës ta aprovoj si të bazuar prapësimin, shfuqizohet urdhri përmbardimor si dhe të obligohet kreditori t'ia kompensoj të gjitha shpenzimet procedurale.

Kreditore në përgjigje në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, ndër të tjera ka deklaruar se debitori ka refuzuar vazhdimisht të respektoj detyrimet e përcaktuara nga Gjykata. Tutje thekson se nuk ka një statut të kufizimeve për të kërkuara shkatërrimin e mallrave lëndore të konfiskuara nga Dogana e Kosovës, në vazhdim deklaron se pretendimi i debitorit se dokumenti nuk është i përshtatshëm për ekzekutim është i pasaktë. Andaj i propozon Gjykatës ta refuzoj prapësimin në tërësi si të pabazuar dhe të urdhërohet debitori ta respektoj urdhrin përmbardimor.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, kundërshtimeve të kreditorit nga përgjigjja në prapësim, shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbardimore (tutje LPP), gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar, andaj të njëjtin e aprovoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 38, paragrafi 1 dhe 2 të LPP-së, përcaktohet se: *“Propozimi për përmbardim duhet ta përmbajë kërkesën për përmbardim në të cilën do të tregohet dokumenti përmbardimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm në bazë të cilit kërkohet përmbardimi, kërkuesi i përmbardimit dhe debitori, adresa e vendbanimit – vendqëndrimit apo selisë afariste të kreditorit dhe të debitorit, kredia që kërkohet të realizohet, si dhe mjeti nëpërmjet cilit duhet kryer përmbardimi, objekti i përmbardimit po qe se është i njohur, si dhe të dhënat e tjera që janë të nevojshme për zbatimin e përmbardimit. 2. Në rast se propozimi për përmbardim nga paragrafin 1. i këtij neni nuk përmban shënimet e kërkuara dhe numrin personal identifikues apo numrin e*

regjistrimit të biznesit të debitorit, organi përmbarues do të veprojë sipas dispozitave të nenit 102 të Ligjit të Procedurës Kontestimore.”

Gjykata, duke iu referuar dispozitave të cekura si më lartë, gjeti se urdhri mbi lejimin e përmbarimit është lejuar në kundërshtim me dispozitën nga neni 38, paragrafi 1, ngase në propozim për përmbarim nuk përmban qartë kërkesën e kredisë e cila kërkohet të realizohet, përkatësisht kredia që kërkohet të realizohet nuk është e përcaktuar në dokumentin përmbarimor në bazë të cilit është kërkuar dhe lejuar përmbarimi.

Me propozimin për përmbarim kreditori ka kërkuar që të urdhërohet debitori për përmbushjen e detyrimeve si në vijim: të ekzekutoj Aktgjykimin II.Ek.nr.328/2017 i datës 25.07.2019, Aktvendimin mbi korrigjim Ek.nr.328/2017 i datës 27.08.2019, Aktgjykimin plotësues Ek.nr.328/2017 i datës 19.09.2019 ose përndryshe, kreditori autorizohet të angazhoj një kompani shkatërrimi për të shkatërruar mallrat në vend të debitorit si dhe debitori të urdhërohet t'i paguaj vlerën prej 14.000.00 € në emër të mbulimit të shpenzimeve me qëllim të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të sipër cekura me kamatën ligjore 8%.

Andaj meqenëse shumat e kërkuara në propozimin për përmbarim dhe të lejuara me urdhrin përmbarimor P.nr.592/21 të datës 24.08.2021, nuk përputhen me dokumentet përmbarimore; Aktgjykimin II.Ek.nr.328/2017 i datës 25.07.2019, Aktvendimin mbi korrigjim Ek.nr.328/2017 i datës 27.08.2019, Aktgjykimin plotësues Ek.nr.328/2017 i datës 19.09.2019, Gjykata vlerëson se propozimi për përmbarim përmban të meta si rezultat i të cilave nuk i plotëson kushtet nga neni 38 i LPP-së.

Me dispozitën e nenit 43, paragrafi 4 të LPP-së, përcaktohet se: *“Në lidhje me ankesën që ngrehë kundërshtimin ndaj urdhrit të përmbarueshmërisë së nxjerrë nga përmbaruesi privat, Gjykata që kryen rishikimin e procedurës së përmbarimit rishikon nëse janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e atij urdhri nga përmbaruesi privat. Nëse Gjykata përcakton se nuk janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e urdhrit për përmbarim nga përmbaruesi privat, Gjykata shfuqizon urdhrin me vendim”.*

Bazuar në dispozitën e lartcekur, gjykata gjen se në rastin konkret urdhri mbi lejimin e përmbarimit është nxjerrë pa u plotësuar kushtet për lejimin e tij, ngase në propozim për përmbarim

është caktuar shuma kërkesa e kreditorit e cila shumë nuk është përcaktuar në dokumentin titull përmbartimor, dhe rrjedhimisht propozimi për përmbartim përmban të meta në kuptim të nenit 38, paragrafi 1 të LPP-së, të cilat tani nuk mund të evitohen.

Gjykata vlerësoi edhe pretendimet tjera të debitorit të paraqitur në prapësim, mirëpo të njëjtat nuk ishin relevante për këtë çështje përmbartimore.

Andaj bazuar në të lartcekurat dhe nenin 43 dhe 73 të Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti i Përgjithshëm

KPPP.nr.1340/22 datë 18.08.2023

Gjyqtari

Gent Bekeri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.